



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja Nr. 38
Prishtinë, më 19.07.2010, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Sanije Aliaj, Rexhep Hoti, Dragiša Mirić, Enis Kervan, Sadik Idriz, Numan Balić, Hafize Hajdini, Hetem Arifi, Zylfi Merxha, dhe Mursel Haljilji.

Munguan: Petar Miletić, Xhevdet Neziraj dhe Müfera Şinik.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi nga OSB-ja Elita Vokshi, përfaqësuesi nga Zëri, D, Bakaj, përfaqësuesi nga RTK, Bardh xx dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Nga Stafi Mbështetës: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Sanije Aliaj, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 9.07.2010 ;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Gjykatat, me raport të Komisionit funksional-Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Vlerësimin e Ndikimin në Mjedis, me raport të komisionin funksional –Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, me amendamente;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Produktet dhe Pajisje Medicinale, me raport të Komisionit funksional-Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalin nga mbledhja e datës 9.07.2010

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjes të datës 9.07.2010, pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Gjykatat, me raport të Komisionit funksional-Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;

Pasi që nuk kishte vërejtje, **kryesuesja** konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Gjykatat dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Vlerësimin e Ndikimin në Mjedis, me raport të komisionin funksional –Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, me amendamente;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Vlerësimin e Ndikimin në Mjedis dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Produktet dhe Pajisje Medicinale, me raport të Komisionit funksional-Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Produktet dhe Pajisje Medicinale dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Të ndryshme

Kryesuesja, e njoftoi Komisionin se në mbledhjen e mbajtur me kryeparlamentarin e Republikës së Kosovës, me kryetarët e Grupeve Parlamentare dhe me kryetarët e Komisioneve Parlamentare, lidhur me aktivitetin dhe procedimin e Ligjeve në komisionet Parlamentare, ka pas vërejtje se Komisioni për Komunitete po i vonon procedurat e Ligjeve, dhe konkretisht është diskutuar për Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore dhe për Projektligjin për Dekoratat.

Enis Kervan, ceku se gjatë takimit me kryeparlamentarin e Republikës së Kosovës, ka dalë informatë se nga përfaqësuesit e komuniteteve të Komisioni për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim, bllokojnë Projektligjet dhe nuk procedohen me kohë.

Ai mendon se këto të dhëna nuk janë të qëndrueshme, sepse komuniteti turk gjithnjë ka proceduar dhe miratuar ligje për Kosovën.

Si çështje e diskutueshme ka mbet Projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore ku Komisioni ka marrë qëndrim të pres ekspertin nga Komisioni Evropian. Ndërsa në Projektligjin për Dekoratat, komuniteti turk ka propozuar një amendament i cili ka pas qëllim paraqitjen e simboleve për komunitetin tonë.

Ai paraqiti vërejtje, se gjatë diskutimeve në Seancë Plenare gjithnjë cekët fjala ‘pakicë apo minorite’ ndërsa thirrëmi si komunitete në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, andaj kërkoi që të definohet kjo shprehje.

Kryesuesja, -Në procedurën e shqyrtimit të Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, Komisioni ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit nuk rregullojnë në mënyrë adekuate çështjet e trajtuara në Ligj, për këtë arsye Komisioni ka kërkuar angazhimin e ekspertit nga Komisioni Evropian, për të dhënë ndihmë profesionale nga fusha e pronësisë.

Gjithashtu, theksoi se Komisioni ka marrë informatë se Projektligji për Dekoratat është kthyer për ndryshim dhe plotësim në Qeveri.

Për këtë arsye ajo mendon se ankesa e cila iu është adresuar komisionit se nuk i ka kryer obligimet e veta është pa bazë, sepse Komisioni për Komunitete ka shqyrtuar dhe proceduar të gjitha Projektligjet me kohë dhe sipas procedurave të dala nga Parlamenti i Kosovës, si të gjitha komisionet tjera.

Numan Balic, vërejtjet në emër të punës së Komisionit për Komunitete nuk kanë bazë, sepse ky komision nuk është pengesë dhe bllokadë për punën e Parlamentit.

Ai konsideron se përfaqësuesit e komuniteteve në këtë komision përfaqësojnë interesat, të drejtat dhe mbrojtjen e të gjitha komuniteteve për çështje të rëndësishme, që është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të gjitha aktet tjera ligjore.

Në emër të anëtarëve të përfaqësuesve të komuniteteve nga Komisioni, Zylfi Merxha, Rexhep Hoti, Mursel Haljilji, Sadik Idriz dhe Hetem Arifi, kanë ndarë të njëjtin mendim dhe qëndrim lidhur me kritikën e cili është adresuar në këtë Komision.

Kryesuesja, konstatoi se në bazë të diskutimeve të dhëna, me shumicë të votave, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim në mbledhjen e mbajtur me 19.07.2010, ka analizuar informatën lidhur me punën e Komisionit, i cili ka dalë nga takimi me kryeparlamentarin e Republikës së Kosovës, me kryetarët e Komisioneve Parlamentare, të mbajtur me datën 15.07.2010.

Në cilësinë e Komisionit të përhershëm dhe kryesor, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar dhe ka bërë vlerësimin e amendamenteve të Projektligjeve, të cilat janë proceduar nga Parlamenti i Kosovës, për të cilat ka hartuar Raporte me rekomandime për tu miratuar në Kuvend. Me këtë rast vlen për të theksuar se deri tani asnjë amendament i Projektligjeve të proceduar në këtë Komision nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Puna e Komisionit nuk ngecë por shkon paralel me punën e komisioneve tjera Parlamentare, edhe pse çdo herë ka vend për punë më efektive.

Në procesin e procedimit të Projektligjin për Shitjen e Banesave, ku Ekziston e Drejta Banesore, Komisioni gjatë shqyrtimit të amendamenteve ka konstatuar se P/ligji nuk rregullon në mënyrë adekuate të drejta dhe interesat e komuniteteve, sa i përket kësaj fushe. Për këtë arsye, komisioni në bashkëveprim me ICO-në dhe OSBE-në, ka kërkuar angazhimin e ekspertit nga Komisioni Evropian, për përkrahje profesionale nga fusha e pronësisë, ku së shpejti edhe kjo çështje do të rregullohet.

Gjithashtu, sa i përket vërejtjes për prolongimin e miratimit të amendamenteve të P/ligjit për Dekoratat të Presidentit, Komisioni zyrtarisht ka marrë informatë nga kryetari i këtij Komisioni, se projektligji është kthyer për ndryshim dhe plotësim sponzoruesit.

Hafize Hajdinit, ajo kërkoi sqarim lidhur me mospjesëmarrje të ministrit të KK dhe ministrit të PMS, pasi në mbledhjen e fundit Komisioni ka marrë pjesëmarrje në komision me qëllim të marrë informata të duhura dhe të nevojshme lidhur me projektin e Dubravës dedikuar komunitetit ashkali, për ndërtimin e disa shtëpive në Ferizaj.

Kryesuesja – theksoi se në bazë të procedurave Parlamentare, ministrat duhet të ftohen 48 orë më herët, ndërsa mbledhja e sotme është caktuar urgjente për arsye të shqyrtimit të këtyre Projektligjeve për procedimi të mëtutjeshëm.

Komisioni, pas konsultimeve të bazuara në këtë kërkesë, u pajtua se në muajin shtator do të ftojë Ministrin për Komunitete dhe Kthim dhe Ministrin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, që të ofrojnë opinionet e tyre lidhur me zhvillimet rreth ndërtimit të 44 shtëpive në Ferizaj,

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetarja e parë Komisionit

Saniye Aliaj